



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 78 paragrafi 2, nenin 80, nenin 81 dhe nenin 82 paragrafi 2 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 08/L-294, nenin 6 dhe nenin 7 të Rregullores (QRK) numër 30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, nenin 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

KONKURS PËR PRANIM

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

Emri i grupit:	Grupi i Përgjithshëm i Shëndetit/Mjekësisë
Lloji i pozitave:	Nëpunës të Shërbimit Publik
Institucioni:	Komuna e Gjakovës
Drejtoria:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Njësia/Spektori:	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Data e njoftimit:	13.07.2026
Afati për aplikim:	14.07.2026 – 12.08.2026
Numri i referencës:	01-111/01-32544
Kohëzgjatja e kontratës:	Katër (4) vite, me të drejtë vazhdimi edhe një mandat tjetër.

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- a. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të strukturës përkatëse organizative dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave.
- b. Menaxhon me stafin e strukturës përkatëse organizative dhe bën ndarjen e detyrave tek varësit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore.
- c. Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë.
- d. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analiza të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
- e. Siguron koordinimin e aktiviteteve me njësitë e tjera organizative të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare për të siguruar efikasitet dhe zbatim të drejtë të proceseve të punës.
- f. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- b. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi.
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- d. Të jetë i aftë për të kryer detyrën përkatëse.
- e. Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- f. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- g. Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.

h. Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

Arsimimi i kërkuar:

- **Për pozitën** Udhëheqës i Departamentit të Mjekësisë Familjare, Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe Udhëheqës i Sektorit të Vaksinit dhe Imunizimit: Specialist i Mjekësisë Familjare (në mungesë të kandidatëve të kualifikuar mund të vijnë në shprehje Doktorët e Mjekësisë).
- **Për pozitën** Kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare: Diplomë Bachelor në Infermieri ose Diplomë e Shkollës së Mesme të Mjekësisë, drejtimi Infermier i Përgjithshëm (barasvlera e infermierit bachelor me infermierin e shkollimit të mesëm ka ardhur si pasojë e dështimit të konkurseve paraprake me numër 01-111/01-16827 të datës 05.11.2024 dhe numër 01-111/01-6563 të datës 05.02.2026).

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në shëndetësi.

4. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Klasa e pagës	Vendi i punës
1.	Udhëheqës i Departamentit të Mjekësisë Familjare	12	H7	QKMF
2.	Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare	12	H7	QMF Cermjan
3.	Udhëheqës i Qendrës së Mjekësisë Familjare	12	H7	QMF Rogovë
4.	Udhëheqës i Sektorit të Vaksinit dhe Imunizimit	12	H7	QKMF
5.	Kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare	6	H14	QMF 1
6.	Kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare	6	H14	QMF Brekoc
7.	Kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare	6	H14	QMF Orize
8.	Kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare	6	H14	QMF Ereniku
9.	Kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare	6	H14	QMF Cermjan
10.	Kryeinfermier i Qendrës së Mjekësisë Familjare	6	H14	QMF Dardani

5. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Ambientet e Shërbimit me Qytetarë*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet fizikisht në *Sektorin për Administrimin e Dokumenteve* apo të dërgohen me postë në këtë adresë: *Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.*

6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar.
- b. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*).
- c. Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vendimin e nostrifikimit

të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit e kontratës në këtë pozitë.

- d. Kopjet e dëshmisë së punësimit (*vërtetim/kontratë*) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale. Përvoja e punës, e cila deklarohej sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
- e. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve.
- f. Kopjen e specializimit.
- g. Kopjen e licencës.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- a. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- b. Dëshmi mjekësore se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- c. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore*).
- d. Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim (*deri në 70 pikë*)
- b. Intervista me gojë (*deri në 30 pikë*)

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (gjakova.rks-gov.net) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>), postën elektronike ose numrin e telefonit të deklaruar në aplikacion.

9. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (*jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi*).
- c. Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit.
- d. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.
- e. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.
- f. Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.
- g. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional siç specifikohet me legjislacionin në fuqi.